



Pranimi / Dorezimi Prilaz / Prilaz Received / Delivery	12.07.2023	3	Viti Year
Organ / Shërbimi Organ / Service Org / Unit	Nr. Prot. Pr. Prot. Prot. No	Shtesa / Prilog Appendix	Sasia / Kantërita Quantity
SKRINSHOCK	5777/2023		1/7



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.786 /2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.786/2023 të datës 29.05.2023 të parashtruar nga ankuesi _____ me adresë _____, kundër Njoftimit të datës 29.03.2023 të Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë të Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 12.07.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

I. Anullohet Vendimi i datës 03.05.2023 i Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë, Njoftimi i datës 29.03.2023 i Njësisë së Personelit si dhe Lista mbi renditjen përfundimtare të kandidatëve e datës 04.05.2023, lidhur me Konkursin për Lëvizje Brenda Kategorisë me numër reference RN00010869 për pozitën e punës "Zyrtar i Lart për Planifikim dhe Zhvillim" në Komunën e Prishtinës si dhe Konkursi për pranimit me numër reference RN00011602 me emrin e grupit Specialist i Arkitekturës për pozitën e punës "Zyrtar i Lart për Planifikim dhe Zhvillim" në Komunën e Prishtinës.

II. Mbetet në fuqi shpallja e Konkursit për Lëvizje Brenda Kategorisë me numër reference RN00010869 për pozitën e punës "Zyrtar i Lart për Planifikim dhe Zhvillim", si dhe çdo veprim procedural i ndërmarr deri në intervistën me gojë, ndërsa çështja kthehet në fazën e vlerësimit nëpërmjet intervistës pranë Komisionit për Lëvizje Brenda Kategorisë në Komunën e Prishtinës.

III. Obligohet Kryetari i Komunës së Prishtinës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore-administrative me qëllim të zbatimit të këtij vendimi siç përcaktohet në pikën II dhe III të këtij dispozitivi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi (tutje *vetëm ankuesi*) më datë 25.05.2023 përmes Postës së Kosovës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar në Këshill me datë 29.05.2023 nën shenjen A.nr.786/2023, kundër njoftimit të datës 29.03.2023 të Komisionit Vlerësues të Komunës së Prishtinës, për shkak të shkeljes së dispozitave ligjore të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative dhe për shkak të heshtjes administrative të organit të punësimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në *tekstin e mëtejme Këshilli*) në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 14.06.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës, ndërsa kjo e fundit më datë 03.07.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat referuar kësaj çështje juridiko-administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit me numër protokollit 4498/2023 të datës 29.05.2023 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkurs nga Komuna e Prishtinës Lëvizje brenda kategorisë për pozitën "Zyrtar i Lart për Planifikim dhe Zhvillim" i datës 30.01.2023; Njoftim nga Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës i datës 07.03.2023; Njoftim nga Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës i datës 29.03.2023; Ankesën e ankuesit drejtuar Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës i datës 31.03.2023; Konkurs nga Komuna e Prishtinës me emrin e grupit Specialist të Arkitekturës i datës 04.05.2023; Pliko me numër RN2895214 i datës 25.05.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 14.06.2023; Përgjigje në ankesë e datës 03.06.2023; Vendim për Themelimin e Komisionit për Vlerësim për Lëvizje Brenda Kategorisë dhe zhvillimin e procedurave të rekrutimit për pozitën "Zyrtar i Lart për Planifikim dhe Zhvillim" në Komunën e Prishtinës me numër Nr.14/020/04-49778/23 i datës 09.03.2023; Lista e aplikantëve nga SIMBNJ; Vendimi i datës 03.05.2023 i Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë të Komunës së Prishtinës; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i R.H. i datës 26.01.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i R.H. i datës 14.01.2023; Vërtetim nga Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës së Jugut e R.H. i datës 09.02.2023; Certifikatë mbi dënimet penale e R.H. i datës 09.02.2023; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës e R.H. me numër Nr.634 i datës 09.10.2012; Letërnjoftim i R.H.; Akt Emërim i R.H. i datës 07.12.2012; Aplikacioni i R.H. i datës 28.02.2023; Renditja përfundimtare e kandidatëve nga SIMBNJ i datës 04.05.2023; E-mail nga Burimet NjerezorePR për C.Z. i datës 07.07.2022; E-mail nga Burimet NjerezorePR për ankuesin i datës 15.03.2023;

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se pretendimet ankimore të ankuesit janë të *bazuara, sepse:*

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë se Komuna e Prishtinës më datë 30.01.2023 ka publikuar Konkursin me numër reference RN00010869 për lëvizje brenda kategorisë, për pozitën e punës "Zyrtar i Lart për Planifikim dhe Zhvillim", me afat të aplikimit nga data 14.02.2023 deri 21.02.2023. Në këtë konkurs ka aplikuar dhe ankuesi i cili sipas shkresave të lëndës është përfshirë në listën e ngushtë si dhe katër (4) kandidatë tjerë të cilët i kanë plotësuar kushtet e konkursit, duke marrë pjesë në të gjitha fazat e procedurës, mirëpo që i njëjti bazuar në vlerësimin e Komisionit për Lëvizje Brenda Kategorisë (*tutje Komisioni i Vlerësimit*) i themeluar sipas Vendimit Nr.14-020/04-49778/23 të datës 09.03.2023, është vlerësuar me gjithsejtë 33.4 pikë, ndërsa Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës, përmes Njoftimit të datës 29.03.2023 ka anuluar konkursin me numër reference RN00010869 për lëvizje brenda kategorisë, për pozitën e punës "Zyrtar i Lart për Planifikim dhe Zhvillim", me arsyetimin se asnjëri nga kandidatët nuk ka plotësuar kriteret e kalueshmërisë së konkursit.

Ankuesi i pakënaqur me vlerësimin e Komisionit të Vlerësimit, me datë 31.03.2023 brenda afatit ligjor parashtron ankesë të brendshme pranë këtij komisioni, ndërsa ky i fundit me Vendimin e datës 03.05.2023 ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill kundër njoftimit të datës 29.03.2023 të Komisionit Vlerësues të Komunës së Prishtinës, pretendon se vendimi i kundërshtuar me ankesë është marrë me shkelje të dispozitave ligjore të nenit 11 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në kundërshtim me nenin 25 paragrafin 4 të Rregullores 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, sepse ende pa marrë vendim lidhur me shqyrtimin e ankesës Komuna e Prishtinës ka shpallur konkurs të hapur për pranim me emrin e grupit Specialist të Arkitekturës.

Referuar konkursit me numër reference RN00010869 si kushte për lëvizjen brenda kategorisë janë përcaktuar: *Të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon; Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë me rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale; Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende; Të jetë vlerësuar të paktën 'mire' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit. Në rastin e konkurimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit. Ndërsa si kërkesa të përgjithshme formale janë kërkuar: **Arsimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të studimeve universitare me të paktë 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to. Kualifikime të posaçme formale: Përvoja e punës së kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.***

Në kuptim të vendosjes meritore lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit, i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik përkitazi me procedurën e lëvizjes brenda kategorisë, konkretisht nenit 38 me të cilin është përcaktuar se: "1. Plotësimi i pozitave të lira në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë. 2. Nëpunësit civilë të së njëjtës kategori në kuadër të Shërbimit Civil, që i plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e posaçme për vendin e lirë, mund të aplikojnë për plotësimin e një vendi të lirë, nëpërmjet procedurës së lëvizjes, sipas paragrafit 1 të këtij neni...:5. Vlerësimi i kandidatëve të interesuar kryhet nga një komision vlerësimi, i krijuar në çdo institucion, bazuar në një intervistë me kandidatët. Komision përbëhet nga pesë anëtarë, njëri nga të cilët është domosdo përfaqësues i Njesisë së Burimeve Njerëzore të institucionit. 6. Në përfundim të vlerësimit, Komisioni mund të vendosë: 6.1. përzgjedhjen e kandidatit më të suksesshëm për t'u emëruar në vendin e lirë, apo; 6.2. përfundimin e procedurës, pa asnjë të

përzgjedhur, në rast se asnjë nga kandidatët e interesuar nuk vlerësohet i suksesshëm për atë vend të lirë të punës.”.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit mori për bazë edhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht: Nenin 44 paragrafit 1 dhe 2, më të cilin është përcaktuar se: *“1.Konkurimi për lëvizjen brenda kategorisë zhvillohet në dy faza: 1.1. verifikimi paraprak i kandidatëve; dhe 1.2. vlerësimi i kandidatëve. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga NJBNJ, ndërsa vlerësimi i kandidatëve kryhet nga Komisioni i Vlerësimit për lëvizjen brenda kategorisë, krijuar sipas nenit 47 të kësaj Rregulloreje”*

Nenin 45 paragrafit 1, 2 dhe 3, me të cilin është përcaktuar se: *“1.Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën konkurohet. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga NJBNJ. 3.Në përfundim të verifikimit paraprak NJBNJ përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lire. Vetëm këta kandidatë kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin”.*

Nenin 47 paragrafin 1, 2, 3 dhe 4, me të cilin përcaktohet se: *“1.KVLBK zhvillon një intervistë me gojë me kandidatët. 2.Nëpërmjet intervistës, KVLBK vlerëson jetëshkrimin/CV, njohuritë, aftësitë apo cilësitë e kërkuara për pozitën e punës për të cilën zhvillohet konkurimi. 3.KVLBK përgatit përpara fillimit të intervistës një grup pyetjesh. Intervista që zhvillohet është e strukturuar dhe me pyetje të njëjta për të gjithë kandidatët e cila përgatitet në ditën e zhvillimit të intervistës.. 4.Vlerësimi maksimal në intervistën me gojë është njëqind (100) pikë”.*

Nenin 48 paragrafin 1 dhe 2, me të cilin përcaktohet se: *“...Pikët e çdo anëtari për çdo vlerësim mbliidhen dhe pjesëtohen me pesë. 2.Në përfundim të fazës të vlerësimit, pikët e përfituara nga secili kandidat në secilën nga hapat e vlerësimit, mbliidhen dhe shuma e pikëve për të gjithë hapat e vlerësimit përbën vlerësimin përfundimtar të konkurimit”.*

Nenin 49 paragrafin 1, 2 dhe 3, me të cilin përcaktohet se: *“1.KVLB në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, harton dhe miraton një listë me vlerësimet përfundimtare të të gjithë kandidatëve. Kandidatët renditen në listë sipas rezultatit të vlerësimit përfundimtar në rendin zbritës. Lista i dërgohet Njësisë Përgjegjëse brenda njëzetë e katër (24) orëve nga miratimi i saj. 2.Kandidati që është vlerësuar me më shumë pikë dhe që ka marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë është kandidati fitues dhe ka të drejtën të emërohet në pozitën e lirë për të cilën është zhvilluar konkurimi. 3.Nëse asnjë nga kandidatët nuk është vlerësuar me gjashtëdhjetë 60 e më shumë pikë, procedura e lëvizjes brenda kategorisë përfundon pa kandidat fitues”.*

Bazuar në dispozitat si më lartë, e në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ka analizuar vendimin e kundërshtuar me ankesë dhe si rrjedhojë ka konstatuar se i njëjti është nxjerrë jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 50 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: *“1.Kundër rezultatit të fazës të vlerësimit, çdo kandidat i interesuar, mund të paraqesë ankesë të brendshme, brenda shtatë (7) ditëve nga data e njoftimit individual. 2.Ankesa shqyrtohet nga KVLBK, dhe vendimi njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj”,* përkatësisht ankuesi ankesën kundër njoftimit të njësisë së presonelit e ka parashtruar më datë 31.03.2023, ndërsa Komisioni i Vlerësimit lidhur me ankesën e datës 31.03.2023 ka vendosur më datë 03.05.2023, veprim ky që bie ndesh me nenin 4 paragrafi 1 dhe nenin 10 paragrafi 2 te Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit konstaton se vendimi i datës 03.05.2023 është nxjerrë me shkelje të dispozitave ligjore të nenit 48 të LPPA-së, pasi nga analizimi i të njëjtit Kolegji ka gjetur se në pjesën hyrëse Vendimi i datës 03.05.2023 (pa numër protokolli) mban shënimin se është nxjerrë nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, e cila nuk ka kompetencë lëndore për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit të datës 31.03.2023, ndërsa në pjesën përmbyllëse vendimi është nënshkruar nga Komisioni i Vlerësimit pa të dhëna sqaruese lidhur me personin zyrtar që ka nënshkruar vendimin në fjalë.

Rrjedhimisht mbi këtë bazë ligjore, Kolegji i'u referua nenit 47 të LPPA-së me të cilin përcaktohet se: "1. Akti administrativ i shkruar përmban: 1.1. pjesën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të cilit i drejtohet akti, shënimi të shkurtër të lëndës së procedurës dhe datën e nxjerrjes; 1.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit. 1.3. pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin); 1.4. pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmbyllëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë", si dhe nenin 48 të LPPA-së me të cilin thuhet se: Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyeve pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. 2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërtshënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe nga vlerësimi i provave materiale të çështjes, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se organi vendimmarrës në arsyetimin e vendimit të kundërshtuar ka dhënë vetëm konstatime të përgjithshme duke mos shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit veç e veç sipas ankesës së datës 31.03.2023, nuk ka bërë shpjegim të gjendjes faktike të çështjes dhe cilat fakte kanë qenë vendimtare për vendimmarrje. Për më tepër vendimi i kontestuar nuk përmban bazën ligjore mbi të cilën është mbështetur vendimmarrja dhe se nuk janë dhënë udhëzime lidhur me të drejtën e ankesës, veprim që është në kundërshtim të plotë me nenin 13 të LPPA-së përkatësisht me parimin e së drejtës për mjete juridike.

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit lidhur me shpalljen e konkursit të jashtëm sipas njoftimit të datës 04.05.2023 për pozitën "Zyrtar i Lart për Planifikim dhe Zhvillim" në Komunën e Prishtinës ende pa marrë vendim lidhur me ankesën e ankuesit në Komision të Vlerësimit. Kolegji fillimisht ka konstatuar se ankuesi ka shterur mjetet e brendshme juridike në Konkursin Lëvizje brenda kategorisë për pozitën e lartë cekur në Komunën e Prishtinës me ankesë, pastaj me datë 29.05.2023 ka parashtruar ankesë në Këshill.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka analizuar dispozitat e Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik konkretisht nenin 24 paragrafin 3 ku përcaktohet se: 3. Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji. E drejta e ankimit në KPMSHC i njihet edhe çdo kandidati në një procedurë pranimit në Shërbimin Civil. Pas shterimit të drejtës së

ankimit në KPMSHC, mund të iniciohet konflikt administrativ në gjykatën kompetente për çështjet administrative si dhe Rregulloren 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës gjegjësisht neni 31 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: 1. Kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil, i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në vijim në tekstin e kësaj Rregullore "Këshilli"). 2. Ankesa në Këshill parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës të organit përkatës që ka nxjerrë aktin apo kryer veprimin që kundërshtohet. Andaj mbi bazë të elaborimit të bazës ligjore të lartcekur Kolegji ka konstatuar se Komuna e Prishtinës me rastin e shpalljes së Konkursit për pranim sipas njoftimit të datës 04.05.2023 me nr. Reference RN00011602 me emrin e grupit Specialist të Arkitekturës për pozitën "Zyrtar i Lart për Planifikim dhe Zhvillim" në Komunën e Prishtinës ka vepruar në kundërshtim me nenin 130 paragrafin 1 të Procedurës së Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: 1. Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, parashtrimi i një ankesë pezullon, sipas fuqisë së ligjit, prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ, deri në njoftimin e vendimit që zgjidh ankesën. Si dhe Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik konkretisht nenin 38 paragrafin 1 ku përcaktohet se: 1. Plotësimi i pozitave të lira në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë.

Nga sa u tha më lart, Kolegji i Këshillit ka analizuar edhe dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përkatësisht nenin 97 paragrafi 2 të këtij ligji më të cilin është përcaktuar se: "... 2. Përfundimi i një procedure administrative të nisur sipas detyrës zyrtare është në diskrecionin e organit publik, përpos kur parashihet ndryshe me ligj dhe bëhet me akt administrativ, dhe si rrjedhojë konstatoi se Komisioni i Vlerësimit me rastin e përfundimit të procedurës së lëvizjes brenda kategorisë, duhet të nxjerr akt përfundimtar i cili duhet të përmbajë të gjitha elementet e aktit administrativ të përcaktuara me nenin 47 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj siç u përcaktua më lart, rrjedhimisht duke qenë procedura e lëvizjes brenda kategorisë për pozitën e punës "Zyrtar i Lart për Planifikim dhe Zhvillim", në Komunën e Prishtinës me numër reference RN00010869 është përcjell me shkelje ligjore referuar fazës së vlerësimit nëpërmjet intervistës, Kolegji i Këshillit vlerëson se pretendimet ankimore të ankuesit janë të drejta dhe të bazuara, ndërsa, duke qenë se akti i shpalljes së konkursit si dhe veprimet e ndërmarra administrative deri në vlerësim intervistën me gojë nuk janë të përfshira me të meta procedurale dhe materiale, Kolegji i Këshillit vendosi që të mbesin në fuqi si të ligjshme shpallja e Konkursit për Lëvizje Brenda Kategorisë me numër reference RN00010869 për pozitën e punës "Zyrtar i Lart për Planifikim dhe Zhvillim", si dhe çdo veprim procedural i ndërmarr deri në intervistën me gojë, ndërsa anulohen Vendimi i datës 03.05.2023 i Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë, Njoftimi i datës 29.03.2023 i Njesisë së Personelit si dhe Lista mbi renditjen përfundimtare të kandidatëve e datës 04.05.2023, ndërsa çështja kthehet në fazën e vlerësimit nëpërmjet intervistës pranë Komisionit për Lëvizje Brenda Kategorisë në Komunën e Prishtinës, me detyrimin që Komisioni i Vlerësimit që me rastin e zhvillimit të intervistës me gojë të merr parasysh të gjeturat dhe pikëpamjet juridike të Kolegjit të dhëna sipas këtij vendimi.


Theksuar si më sipër, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.786/2023.

Çlirim Zeka


Procesmbajtës

Eshref Shabani


Kryetar Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

